



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR.7
Datë 09.06.2026 ora 14 : 00 ⁰⁰

Zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak me Nr.2292. Prot datë 05.06.2026, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.6, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 28.05.2026.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.
- 5- Miratim i projekt- vendimit, “Për përdorimin e fondit të emergjencave civile”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Plan Masash ‘Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhet të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret’ “.
- 7- Miratim i projek t- vendimit, “Për miratimin e programit të transparencës së Bashkisë Rrogozhinë”.
- 8- Shqyrtim i kërkesës për informacion dhe ndërhyrje institucionale të anëtarit të këshillit bashkiak z. Mitat Daja.
- 9- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Mitat Daja, Sokol Gosa, Saimir Cani, Silvana Aliu, Mukades Gixhari, Shpati Kolgega.



Mungojnë :

Dhurata Meka, Merilin Saraçi, Besnike Coraj, Lije Dedej, Indrit Dedej, Hekuran Xhani, Erind Tosku, Lulzim Hasa.

Të ftuar :

1. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
4. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
6. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Diasporës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Megi Toska - Drejtore e Kadastrës.
10. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
11. Lorenc Boriçi - Kryeinspektor i policisë bashkiake.
12. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të pyjeve.
13. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Zëvendëskryetar i Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 11- Këshilltarë. z. Shpati Kolgega i bashkohet në vijim mbledhjes së Këshillit.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përsëritet të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!



-Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Altin Tosku, Mitat Daja, Sokol Gosa, Saimir Cani, Silvana Aliu, Mukades Gixhari. Jemi 11- në total.

-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 28.05.2026 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar , si më poshtë :

Vendim nr . 20 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%

Vendim nr . 21 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2026 nga fondi i pushtetit vendor.

Mukades Gixhari . Atëherë kalojmë në rendin e ditës. Miratimin e rendit të ditës e hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro, miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 1 (një) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.6, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 28.05.2026. E hedhim në votim pro, kundër, abstenim. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Pika 3-të , Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2026 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Fjala për drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Përsëritet ! Në total janë 9-familje dhe fondi është rreth 47 mijë lekë të reja.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje në lidhje me këtë pikë? Meqë nuk keni pyetje e hedhim në votim. Pro, kundër abstenim. Të gjithë pro, miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro, 0-kundër, 0-abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.

Vendim nr.22. Miratohet me 11- vota pro, projektvendimi i propozuar nga Zv. Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.2249.Prot datë 04.06.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2026 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.2249/1.Prot datë 04.06.2026.



Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029. Fjala për drejtorin e financës z. Rezart Vogli.

Mitat Daja . A u kalua pika 3? Kam një ndërhyrje këtu zysh..

Mukades Gixhari . Po z. Mitat. Në lidhje me pikën që kaluam?

Mitat Daja . Jo në përgjithësi. Që të jemi dhe pak të qartë. Sa për informacion ne kemi ardhur për të kaluar këto që janë më të rëndësishmet , këto as bukë e gojës nuk quhet po... edhe duke na konsideruar ne si këshill po të dëgjosh administratën e bashkisë thonë ky këshill është kot nuk ja vlen dhe ne do merremi deri kur administrata të kthehet në shinat e duhura do merremi vetëm me ato që janë të rëndësishme. E rëndësishme është ndihma ekonomike se herë pas here ne bëjmë kërkesa në administratë ajo nuk i merr parasysh fare ose kujtohet nga fundi kur i tekton atyre me e dhënë një përgjigje që nuk është shteruese fare, e para. E dyta punës duket më shumë hipokrizi që ne vetëm ngrejmë dorën dhe miratojmë. Miratohet thotë për përdorim fond emergjence edhe vjet dhe çdo vit kemi miratuar bashkisë fond emergjence njëherë donim një skrep me bisht të gjatë një ditë tjetër kërkuam një skrep me bisht të shkurtër edhe situata është po e njëjta. Një herë kërkojnë ambulancë njëherë kërkojnë zjarrfikëse dhe pastaj asaj zjarrfikëses i prishet motori në mes të rrugës dhe kur shikoj këtu diskutimin për plan masash për miratimin kundër zjarreve kjo më duket edhe më ulëritëse. Duket më ulëritëse me atë që kemi parë vjet që ne çdo vit e kemi bërë kur ti nuk ... kur flas ti flas ju ose bashkia nuk e kanë vënë ujin në vi për të bërë asnjë gjë unë i drejtoj pyetje hipotetike drejtorit të pyjeve. A ka hapur ndonjë rrugë ky drejtori i pyjeve që të mos kalojë zjarri apo të merren masa apo do vazhdojmë të mbajmë lopatën aty tek kasollja dhe kërkon sot që të bëjmë ne miratim masash. Për mua është hipokrizi, nëse ka mbaruar miratimi i ndihmës unë ju falenderoj që erdhët u bëtë pjesë dhe unë ftoj dhe kolegët e tjerë në shenjë solidariteti të çohemi të ikim kur të vijë muaji tjetër miratojmë ndihmën ekonomike dhe vazhdojmë punën. Deri kur administrata e bashkisë Rrogozhinë të kthehet në rrugën e duhur mos thotë që ky këshill është vari teneqen siç e thonë nëpër rrugë, se dhe fjalët dëgjohen dhe na vijnë çfarë thonë por të japin respektin e duhur sepse ne jemi përfaqësues të njerëzve dhe njerëzit kanë halle. Kemi bërë kërkesë për tërmetin se ka vrarë mendjen bashkia të sjelli asnjë lloj informacioni, kemi bërë kërkesa tjera dhe unë kam bërë kërkesa dhe sot përfundimisht pas miratimit të kryetarit në detyrë meqë ju zysh nuk ishit për kërkesat e mia me shumë vështirësi pranoi që t'i vendosi tek pika e fundit. Pra nuk besoj se ka gjë tjetër për të shtuar më unë ju falenderoj që të gjithëve kush do të solidarizohet është i lirë, kush do të rrijë secili ka mendimin e tij edhe sot është dita ku secili jep mendimin e vet kaq kisha.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

-Mbledhjes i bashkohet Këshilltari z. Shpati Kolgega rreth minutës së 5 të zhvillimit të saj.

Mukades Gixhari . Sa për administratën ne e kemi këtu drejtorët...

Mitat Daja . Nuk më duhen më zysh sepse nuk kanë sjellë... nuk më duhen ...

Mukades Gixhari . Ju sapo thatë që të ju japin shpjegime...

Mitat Daja . Dëgjo zysh meqë jemi në publik të na dëgjojë dhe publiku . Unë nuk i kam kërkuar administratës informacion në email-in tim personal, as atë nuk e kanë sjellë, unë nuk e dua informacion publik. Dhe nuk i kam kërkuar informacion administratës për t'i bërë presion administratës i kam kërkuar që dhe njerëzit publiku të informohet . Adminstrat se ka vra mendjen punë e atyre le ta gjykojnë njerëzit këtë gjë do më gjykojnë dhe mua po vjen koha të na gjykojnë të gjithëve le të gjykojnë njerëzit. Jo unë do vazhdoj, ju mund të vazhdoni.

Mukades Gixhari . Të marrësh një përgjigje...

Mitat Daja . Jo nuk e dua e kam marrë përgjigjen, kaq kisha përgjigjen e kam marrë .

Mukades Gixhari . Përgjigjet na duhen...

-Këshilltarët Mitat Daja, Silvana Aliu, Altin Tosku largohen nga mbledhja.

Mukades Gixhari . Meqë nuk kemi më kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 20⁰⁰ . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 09 min ; 16 sek.

- Ky procesverbal i mbyllet në faqen **5 (pesë)**.

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera

